

OBSERVATORI I EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE



BULETINI I RREZIQEVE

PËRMBLEDHJE E PIKAVE KRYESORE

1. Një rilindje e krimit në Novi Pazar?

Një valë e madhe incidentesh të dhunshme e ka kthyer përsëri në hartë Novi Pazarin në Serbinë e Jugut si një pikë të nxehtë të krimit të organizuar. Qyteti, i cili ndodhet përgjatë rrugëve kryesore të trafikut, dikur kishte reputacionin e depos kryesore të heroinës në Evropë. Do të shohim lidhjet e saj të kaluara dhe të tanishme me ekonomitë e paligjshme.

2. Drogat sintetike në Ballkanin Perëndimor.

Ballkani Perëndimor është i famshëm si një rajon tranzit për trafikimin e drogave, si kanabisi, kokaina dhe heroina. Por, siç shqyrtohet në këtë artikull, ka shenja që tregojnë se rajoni është gjithashtu edhe një prodhues i drogave sintetike, si edhe një treg në rritje i konsumit të tyre.

3. Ujëra të trazuara: kontrabanda e emigrantëve përmes Adriatikut.

Operacionet e fundit të kërkim-shpëtimit në Adriatik pranë brigjeve të Shqipërisë dhe Malit të Zi sugjerojnë se një numër në rritje i emigrantëve po kontrabandohen me anije nga molet dhe portet e atyre dy vendeve. Do të shikojmë rastet e fundit dhe se çfarë tregojnë ato në lidhje me një zhvendosje në rrugët dhe metodat e kontrabandës.

4. Mësimet e nxjerra nga legalizimi i kanabisit në Maqedoninë e Veriut.

Në mars 2016, Maqedonia e Veriut legalizoi kultivimin dhe eksportimin e kanabisit për përdorim mjekësor. Ne do të shikojmë mësimet e nxjerra nga përvoja e Maqedonisë së Veriut gjatë pesë viteve të fundit, veçanërisht në lidhje me rregullimin dhe rrezikun që kanabisi i rritur në mënyrë të ligjshme të përfundojë në tregun e zi.

5. Fuqizimi i të rinjve në Vlorë.

Qyteti i Vlorës në Shqipërinë e Jugut ka reputacionin si një vend që prodhon kriminelë të cilët i aplikojnë aftësitë e tyre brenda dhe jashtë vendit. Për më shumë se 20 vjet, Qendra Rinore e Vlorës ka punuar me të rinjtë në komunitet për të zgjeruar horizontet, aftësitë dhe mundësitë e tyre për t'i mbështetur ata përgjatë një rruge drejt një jete brenda ligjit. Ne flasim me drejtoreshën e qendrës, Alketa Dhimitri, për punën e saj, sfidat dhe mundësitë që ajo sheh.



RRETH KËTIJ NUMRI

Mirë se vini në numrin e pestë të “Buletinit të rreziqeve” të prodhuar nga Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore. Ashtu si në numrat tanë të mëparshëm, ne do të fillojmë duke parë një pikë të nxehtë të krimit të organizuar, kësaj here Novi Pazarin në Serbinë e jugut. Më pas do të shohim prodhimin dhe përdorimin e drogave sintetike në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut. Ne gjithashtu do të përqendrohemi në rastet e fundit të kontrabandës së emigrantëve nga brigjet e Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Në shumë vende të botës, ekziston një tendencë drejt dekriminalizimit dhe madje legalizimit të kanabisit. Ne do ta shikojmë çështjen në kontekstin e Ballkanit Perëndimor,

veçanërisht lidhur me përvojën në Maqedoninë e Veriut gjatë pesë viteve që kur legalizoi kultivimin, prodhimin dhe eksportimin e kanabisit për përdorim mjekësor.

Si gjithmonë, do të përfundojmë me profilin e punës të një organizate të shoqërisë civile nga Ballkani Perëndimor që punon për të forcuar rezistencën ndaj krimit të organizuar. Këtë muaj, do të flasim me drejtoreshën e Qendrës Rinore Vlorë në jug të Shqipërisë për sfidat dhe mundësitë që ajo sheh në punën e saj me të rinjtë.

Nëse keni një propozim për një histori ose dëshironi të reagoni, ju lutemi kontaktoni me Kristina.Amerhauser@globalinitiative.net.

1. Një rilindje e krimit në Novi Pazar?

Në mes të dhjetorit 2020, u dëgjuan të shtëna në rrugët e Novi Pazarit. Në mes të ditës, pranë një stacioni policie, pronari i një klubi nate me një dëshmi penaliteti të gjatë dhe djali i tij qëlluan mbi një burrë nga makina e tyre në lëvizje, duke plagosur një kalimtar të rastit.¹ Dy ditë më vonë, në mes të ditës, u qëlluan disa plumba në drejtim të një burri të ulur në një kafene në qendër të qytetit i cili, jo shumë kohë më parë, thuhej se ishte në shoqërinë e dy oficerëve të policisë.² Në një përgjigje të profilit të lartë ndaj këtyre të shtënave, ministri i brendshëm serb dërgoi xhandarmërinë për të patrulluar qytetin dhe për të kryer bastisje.³ Ekziston një ndjenjë e dukshme frike në qytet dhe njerëzit mbajnë thika dhe armë të tjera për t'u mbrojtur. Pas disa vitesh stabiliteti relativ, Novi Pazar është përsëri nëpër lajme si një pikë e nxehtë e krimit të organizuar.

Novi Pazar ndodhet në Serbinë jugperëndimore (në rajonin e Sanxhakut) pranë Malit të Zi, Kosovës dhe Bosnjë e Hercegovinës. Për shkak të vendndodhjes së tij, qyteti me shumicë boshnjake me rreth 120 000 banorë ka qenë tradicionalisht qendër e tregtisë dhe e trafikimit.⁴ Ashtu si pikat e tjera të nxehta kriminale në Ballkanin Perëndimor të identifikuar nga Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), Novi Pazar është i pazhvilluar: paga mesatare mujore është 353 euro, 60 euro më pak se mesatarja kombëtare, ndërsa 12% e popullsisë varet nga ndihma sociale.⁵ Rreth një e pesta (20 768) e popullsisë së rritur është e papunë.⁶ Shumë banorë

të qytetit dyshohet se i nxjerrin disa nga të ardhurat e tyre nga remitancat ose kontrabanda. “Gjithçka është e kontrabanduar - druri, bagëtia, ushqimi, veglat, makinat, tekstilet,” tha një aktivist lokal i shoqërisë civile.⁷ Për shkak të vështirësive ekonomike, shumë të rinj po largohen nga zona.⁸ Disa nga ata që qëndrojnë merren me veprimtari kriminale.

Novi Pazar dikur ishte një qendër e njohur për aktivitetet kriminal, shumica e të cilit ishte përqendruar rreth familjes Hajroviç. Në vitet 1990 dhe fillimin e viteve 2000, Hikmet Hajroviçi u vlerësua si një nga bosët më të mëdhenj serbë të drogës, veçanërisht për heroinën e kontrabanduar nga Turqia për në Novi Pazar. Grupet kriminale kontrabandonin dërgesa droge në ndarje të modifikuara posaçërisht në kamionë, autobusë ose furgonë. Heroina që kontrabandononte Hajroviçi thuhej të ishte me një pastërti të jashtëzakonshme, ndër atyre me cilësinë më të mirë në Evropë, dhe disa prej dërgesave peshonin qindra kilogramë. Në vitin 2008, Departamenti i Shtetit i SHBA-së e quajti rajonin e Sanxhakut si “magazina e heroinës” së Evropës.⁹ Nga Novi Pazar, kriminelët kontrabandonin drogë në qytet të tjera të Serbisë, kryesisht në Beograd dhe më tej në Evropën Perëndimore, deri në Londër. Hajroviçi u arrestua përfundimisht në vitin 2011 dhe u dënua në vitin 2013 me 15 vjet burg, bazuar në një marrëveshje për pranimin e fajësisë.¹⁰




FIGURA 1 Rrugët e trafikut të drogës brenda dhe rreth Novi Pazarit.




FIGURA 2 Çmimet në rrugë për drogat në Novi Pazar.

Deri në të shtënat e fundit, ditët e lulëzimit kriminal të Novi Pazarit dukej se kishin kaluar. Kriminelët nga vitet 1990 dhe fillimi i viteve 2000 dyshohet se i kishin investuar pasuritë e tyre në biznese të ligjshme dhe e kishin braktisur krimin. Trafikimi i heroinës u mor përsipër nga grupe më të mëdha dhe më të fuqishme të përfshira në trafikimin e kokainës nga jashtë Sanxhakut. Ndërsa heroina dhe kanabisi trafikohen ende përmes Novi Pazarit (veçanërisht përmes Rozajes në Mal të Zi),¹¹ vëllimi thuhet të jetë më i ulët se në të kaluarën.

Ekzistojnë gjithashtu prova të drogave sintetike në Novi Pazar, kryesisht ekstasia e prodhuar në Evropën Perëndimore dhe markat e njohura si Super Mario dhe Ladybug.¹² Sipas të dhënave të policisë, çmimi në rrugë i marijuanës është rreth 1000 dinarë serbë (RSD) ose 8,5 euro për gram; heroina, amfetamina dhe ekstasia janë secila 1500 RSD për gram (7 euro), ndërsa një gram kokainë kushton 8000 RSD (68 euro).¹³ Sidoqoftë, ata që e njohin tregun lokal të drogës thonë se çmimet reale janë më të ulëta.¹⁴

Megjithëse roli i Novi Pazarit si qendër e trafikut të drogës është më i vogël se në të kaluarën, problemi nuk është zhdukur. Që nga viti 2015, 114 persona janë ndjekur penalisht për prodhimin, mbajtjen ose shitjen e paligjshme

të lëndëve narkotike në Novi Pazar. Gjykata i dënoi ata me një total prej 281 vitesh burg. Shumica e dënimeve kanë qenë të vogla. Një përjashtim i rrallë ishte dënimi me shtatë vjet burg i një shpërndarësi për posedimin e 21 kilogramëve marijuanë të destinuara për shitje.¹⁵ Policia ka arrestuar kriminelët nga Novi Pazarit në vende të tjera, të tilla si Hungaria dhe Turqia, në posedim të dhjetëra kilogramëve kanabis. Dhe grupet lokale, megjithëse më të vogla dhe më pak të fuqishme se në të kaluarën, raportohet se bashkëpunojnë me grupe kriminale nga Kosova, Beogradi, Çaçaku dhe Novi Sadi.¹⁶

Mënyra e punës së disa grupeve nga Novi Pazarit duket se është vjedhja e drogës nga kriminelët e tjerë.¹⁷ Në vitin 2019, një grup nga Novi Pazarit dyshohet se vodhi 6 kilogramë kokainë në Slloveni nga klani malazez i Kavaçit. Disa muaj më vonë, në dhjetor 2019, një anëtar i të njëjtit grup të Novi Pazarit¹⁸ u qëllua në Beograd gjatë dorëzimit të një sasive droge.¹⁹ Droga dhe rreth 300 000 euro në para të thata që ai kishte me vete u zhdukën.²⁰

Koha do të tregojë nëse këto incidente të fundit në Novi Pazar janë vetëm një shpërthim i përkohshëm apo nëse tregojnë për një rikthim në të kaluarën famëkeqe të qytetit.

2. Drogat sintetike në Ballkanin Perëndimor.

Ballkani Perëndimor shpesh etiketohet si një rajon tranzit për trafikimin e drogave, si kanabisi, kokaina dhe heroina. Por, ka shenja që tregojnë se rajoni është gjithashtu edhe një prodhues i drogave sintetike, si edhe një treg në rritje i konsumit të tyre.

Drogat kryesore sintetike që kontrabandohen në Ballkanin Perëndimor janë amfetaminat, metamfetamina dhe ekstasia (MDMA), si dhe versione të reja sintetike të kanabisit dhe opioideve si heroina. Burimi kryesor i drogave janë vendet në Evropën Perëndimore, veçanërisht Holanda, Belgjika, Republika Çeke dhe Bullgaria.²¹ Në Serbi, ekziston gjithashtu një tendencë në rritje për të importuar droga sintetike nga vendet Baltike²² dhe Euroazia, duke përfshirë Afganistanin, Iranin, Kirgistanin, Pakistanin dhe Uzbekistanin.²³

Për më tepër, prodhimi vendas duket se po rritet, veçanërisht në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Midis viteve 2009 dhe 2019, policia në Serbi zbuloi mbi 140 laboratorë të paligjshëm të drogës, kryesisht në ambiente banimi.²⁴ Shumica e laboratorëve kryesorë në Serbi janë në rrethinat e Beogradit ose në Nish.²⁵ Një prej zbulimeve më të mëdha ishte në vitin 2003 në qytetin e vogël Stara Pazova (në provincën veriore të Vojvodinës), ku policia gjeti rreth 2 milionë tableta ekstasie me vlerë mbi 4 milionë euro, si dhe afërsisht 20 tonë acid për prodhimin e ekstasisë, me vlerë që mendohet të jetë mbi 10 milionë euro. Megjithatë, vetëm 245 persona u dënuan, mesatarisht më pak se dy persona për laborator të paligjshëm të zbuluar.²⁶ Kjo tregon që policia po kap vetëm "gatuesit" dhe jo të gjithë ata që përfshihen në rrjetet e prodhimit dhe shpërndarjes.



Rritja e aksesit të të rinjve në drogat sintetike ka shtuar shqetësimet shëndetësore në Serbi. Foto: serpeblu/iStock

Në vitin 2020, shumica e sekuestrimeve të drogave sintetike në Serbi u bënë ose në Beograd dhe Novi Sad ose afër kufirit me Hungarinë, për shembull në pikën e kalimit kufitar të Horgosit. Sekuestrime u bënë gjithashtu në Kragujevaç dhe Bor.²⁷

Problemi nuk është i kufizuar me Serbinë. Në dhjetor 2017, policia zbuloi laboratorë të paligjshëm të drogës në fshatin Batinçiq dhe në një shtëpi afër Tetovës në Maqedoninë e Veriut.²⁸ Ata sekuestruan rreth 910 000 tableta Captagon, 52 kilogramë amfetaminë të pastër dhe sasi të mëdha substancash që përdoren për prodhimin e lëndëve narkotike. I dyshuari kryesor, Milan Zarubica, ishte dënua më parë në lidhje me një laborator në Stara Pazova, Serbi. Disa muaj më vonë, policia maqedonase gjeti edhe një laborator tjetër që përdorej për prodhimin e paligjshëm të drogave sintetike.

Përveç trafikimit dhe prodhimit, duket se ka një treg vendas në rritje për drogat sintetike.²⁹ Në Serbi po shfaqen substanca të reja psikoaktive, kryesisht kanabinoide sintetike, të cilat imitojnë drogat tradicionale të paligjshme si kanabisi, kokaina, MDMA dhe LSD-ja.

Në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut, çmimet për drogat sintetike janë relativisht të ulëta, që është një faktor kryesor në rritjen e përqindjes së tyre të tregut krahasuar me drogat me bazë bimore.³⁰ Pesë tableta ekstasie mund t'i blijnë për rreth 25 euro.³¹ Përveç kësaj, ka edhe substanca si amfetamina Tucibi (2C-B) e cila njihet si një "drogë elitare" për shkak të kostos së saj të lartë dhe efekteve të forta psikodelike. Droga zakonisht shitet në tregun e zi në formën e tabletave ose kapsulave, por gjithashtu mund të përzihet me ekstasi.³² Në vitin 2019, policia në Nish arrestoi një person që zotëronte pothuajse 175 gramë Tucibi.³³

Drogat sintetike gjenden lehtësisht, veçanërisht në qytetet e mëdha.³⁴ "Tregu në Serbi është i mirëfurnizuar me amfetaminë, ekstasi dhe MDMA", tha një person me njohuri të situatës në rrugë. Metamfetamina është më pak e pranishme në Serbi.³⁵ Por, marijuana dhe heroina janë drogat më të përdorura në Serbi, të ndjekura nga "speed".³⁶

Është e paqartë se si COVID-19 ka ndikuar në tregun e drogës sintetike në Ballkanin Perëndimor, por ekziston një ndjesi se tregu është relativisht elastik, ku disa droga sintetike që përdoren si zëvendësues të heroinës.³⁷ Përdoruesit po i drejtohen internetit për të gjetur furnitorë pasi ata nuk mund t'i takojnë shpërndarësit nëpër klube ose nëpër festivale si në të kaluarën.³⁸

Megjithëse heroina mbetet shkaku kryesor i rreth 50 vdekjeve të lidhura me drogën në Serbi çdo vit,³⁹ rritja e aksesit në drogat sintetike dhe e përdorimit të tyre kanë shtuar shqetësimet shëndetësore në vend dhe kanë çuar në vdekje tragjike të të rinjve të lidhura me drogën. Pas vdekjes së një vajze 15-vjeçare në nëntor të vitit 2018 në qytetin e vogël të Arandjelovaçit, pas marrjes së ekstasisë për herë të parë në një festë, vendasit organizuan një seri protestash duke kërkuar masa më të forta parandaluese.⁴⁰ Në qytetin fqinj të Lazarevaçit, banorët vendosën afishe nëpër qytet me fotografi të shpërndarësve lokalë të drogës. Në vitin 2018, katër të rinj të moshës 17 deri 21 vjeçare vdiqën pasi morën ekstasi, ndërsa midis viteve 2009 dhe 2019 më shumë se pesëdhjetë vetë vdiqën në vend nga drogat e ndryshme sintetike.⁴¹

Megjithëse fokusi te drogat në Ballkanin Perëndimor zakonisht ka qenë te tranziti i substancave me bazë bimore si kokaina, heroina dhe kanabisi, është gjithashtu e rëndësishme të mbahet nën radar edhe prodhimi dhe përdorimi i drogave sintetike.




FIGURA 3 Portet dhe molet në rrezik për t'u përdorur për kontrabandën e emigrantëve.

3. Ujëra të trazuar: kontrabanda e emigrantëve përmes Adriatikut.

Më 9 janar 2021, u shpëtuan në një det të trazuar pranë brigjeve të Shqipërisë 55 emigrantë nga Siria, Irani dhe Egjipti, duke përfshirë gra dhe fëmijë. Skafi me të cilën kishin udhëtuar, i cili ishte nisur nga Vlora e Shqipërisë, ishte prishur rrugës për në Itali. Skafistët ishin larguar dhe skafin po e merrnin rrymat dhe po rridhte karburant.⁴²

Ky operacion shpëtimi ndodhi pas dy incidenteve në tetor dhe dhjetor 2020 ku autoritetet malazeze kapën dy varka me vela që po përpiqeshin të kontrabandonin kurdë nga Turqia përmes Ballkanit Perëndimor në Itali. Këto ndodhi tregojnë se zbatimi më efektiv i ligjit dhe kufizimet e lidhura me COVID-19 përgjatë itinerarit tradicional të Ballkanit kanë bërë që kontrabandistët të zgjedhin rrugë alternative, duke përfshirë itinerarin detar të Adriatikut. Mbyllja e itinerarit të Ballkanit në mars 2016 çoi në një rënie të ndjeshme të numrit të azilkërkuesve dhe emigrantëve që lëviznin përmes Ballkanit Perëndimor. Por që nga viti 2019, numri i refugjatëve dhe emigrantëve është rritur përsëri në mënyrë të vazhdueshme.

Për shkak të përmirësimit të kontrolleve të kufirit midis Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut, një numër në rritje njerëzish në lëvizje po udhëtojnë përmes Shqipërisë. Sapo kalojnë në vend, ata ose drejtohen në veri drejt Malit të Zi ose në verilindje përmes Kosovës në Serbi. Për më tepër, në muajt e fundit ka pasur shenja të përpjekjeve në rritje për të kontrabanduar njerëz nëpërmjet detit Adriatik në Itali.

Të 55 emigrantët që u shpëtuan më 9 janar thonë se u kishin paguar kontrabandistëve nga 2000 deri 4000 dollarë secili për transport të sigurt me jaht në Itali. Në vend të kësaj, u transportuan me skaf.⁴³ Në fillim të janarit, policia në Vlorë ndaloi 21 emigrantë të tjerë që po planifikonin të kalonin në mënyrë të paligjshme Adriatikut.⁴⁴

Itineraret e kontrabandës janë të përcaktuara prej kohësh, që nga fillimi i viteve 1990 kur dhjetëra mijëra shqiptarë u përpoqën të emigronin në Itali. Në vitin 2004, saktësisht 17 vjet nga dita para shpëtimit të 55 emigrantëve, u mbytën në det 28 shqiptarë ndërsa përpiqeshin të kalonin nga Vlora përmes Ngushticës së Otrantos për në Itali.⁴⁵ Tani janë kryesisht të huajt nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut ata që po kontrabandohen në Itali nga brigjet shqiptare.

Në të kaluarën, të njëjtat itinerare përdorshin për të kontrabanduar drogë, veçanërisht kanabis, duke përdorur skafet. Problemi ishte aq i rëndë sa skafet u sekuestruan dhe u dogjën nga qeveria shqiptare. Në vitin 2006 u vendos një moratorium i skafeve në ujërat territoriale shqiptare,⁴⁶ i cili më në fund u hoq në vitin 2013, për të lehtësuar industrinë e turizmit.⁴⁷ Itinerari i kontrabandës nga vija bregdetare përrreth Fierit dhe Vlorës përmes ngushticës së Otrantos për në Itali u bë përsëri i famshëm në vitin 2016 kur kishte prodhime të mëdha të kanabisit në Shqipëri, por më pas u ndalua. Do të jetë interesante të shihnim se si do të reagojë qeveria shqiptare nëse problemi përsëri përkeqësohet.

Mali i Zi fqinj po përballet me një sfidë të ngjashme. Në tetor 2020, në molin e Zelenikës policia malazeze kapi një anije me vela të quajtur *Poseidon* me flamur kroat dhe ekuipazh serb; ajo ishte nisur nga Budva dhe po shkonte drejt Italisë.⁴⁸ Gjatë inspektimit të anijes, policia zbuloi 52 emigrantë kurdë në bord.⁴⁹ Kontrabandistët në Turqi që kishin përgatitur udhëtimin kërkonin nga 5000 deri 8000 euro për person për transferimin në Itali, sipas burimeve

të policisë.⁵⁰ Kjo do të thotë që kontrabandistët fitonin afërsisht 300 000 euro vetëm nga një grup prej rreth pesëdhjetë emigrantësh, ndërsa kostot vlerësoheshin në rreth 100 000 euro,⁵¹ duke lënë një marzh të konsiderueshëm fitimi.

Më 17 dhjetor 2020, policia malazeze dhe autoritetet e sigurisë detare, duke përdorur një sensor me imazheri termike, zbuluan një mjet lundrimi të panjohur rreth gjirit të Tërstenos, pranë Budvës. Në bashkëpunim me autoritetet italiane, u nis një helikopter vëzhgimi nga Guardia di Finanza. Anija, e quajtur *Marina*, kishte flamur suedez; ajo u interceptua dhe u shoqërua në portin e Tivarit.⁵² Në bord, policia gjeti 39 emigrantë (duke përfshirë gra dhe fëmijë) dhe arrestoi dy kontrabandistë nga Turqia.⁵³

Këto incidente na tregojnë një numër gjërash. Së pari, kontrabanda e emigrantëve përmes Ballkanit Perëndimor nuk është zhdukur; përkundrazi, ajo ka lëvizur më në perëndim. Shqipëria, e cila për tre dekada ka qenë vend burimi për emigracionin, tani është gjithashtu edhe vend tranziti. Së dyti, përveç përpjekjeve për të arritur Bashkimin Evropian përmes Shqipërisë dhe Malit të Zi në rrugë tokësore, disa emigrantë po përpiqen të hyjnë në Itali me skaf. Historitë e përfshira në këtë artikull tregojnë se ka kontrabandistë që janë të gatshëm të ofrojnë udhëtime të tilla me fitim të konsiderueshëm. Së treti, këto incidente nxjerrin në pah vulnerabilitetin e moleve dhe zonave informale të ankorimit në bregdetin e Adriatikut si parajsë të kontrabandës. Ky është një rrezik që meriton më shumë vëmendje, sidomos nga zyrtarët e zbatimit të ligjit.

4. Mësimet e nxjerra nga legalizimi i kanabisit në Maqedoninë e Veriut.

Në mars 2016, Maqedonia e Veriut ndryshoi ligjin "Për kontrollin e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope".⁵⁴ Si rezultat, u bë e ligjshme rritja e kanabisit për qëllime mjekësore dhe rafinimi, nxjerrja dhe prodhimi i farave të kanabisit dhe vajit të kanabisit. Maqedonia e Veriut iu bashkua kështu një numri në rritje vendesh (36 duke përfshirë Kroacinë që nga viti 2019 dhe Greqinë që nga viti 2018) që lejojnë kultivimin dhe eksportin e kanabisit mjekësor. A është ky një biznes me rrezik apo model i mundshëm për vendet e tjera në rajon?

Duke kopjuar metodën e veprimit të Kanadasë, Maqedonia e Veriut prezantoi një metodë veprimi të tregut të lirë për kultivimin, shpërndarjen dhe shitjen e kanabisit. Ky është një përfitim për ekonominë me vlerë rreth 100 milionë euro në vit që ka tërhequr investitorë vendas dhe të huaj.⁵⁵ Konkurrenca për prodhimin e kanabisit mjekësor në Maqedoninë e Veriut po rritet me shpejtësi.

Nga maji i vitit 2016 deri në maj të vitit 2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhanë gjithsej pesë licenca për prodhimin e kanabisit për përdorim mjekësor dhe dy licenca për nxjerrjen e ekstrakteve. Që atëherë, sipas të dhënave të qeverisë, një total prej 55 kompanish kanë marrë licenca për të rritur kanabis për qëllime mjekësore; 17 kompani të tjera janë në pritje të miratimit.⁵⁶ Një numër nga këto kompani thuhet se janë të lidhura me kryeministrin dhe miq e familjarë të tij.⁵⁷


Numri i lartë i licencave që janë lëshuar do të thotë që tani në Maqedoninë e Veriut po rritet një sasi e konsiderueshme kanabis. Sidoqoftë, midis investitorëve ekzistojnë shqetësimi se oferta po tejkalon kërkesën dhe se mundësia për biznes mund të mos jetë aq fitimprurëse sa ishte parashikuar fillimisht. Duhet të kihet parasysh se legjislacioni aktual nuk e lejon eksportin e kanabisit të thatë për përdorim rekreativ.

Rregullorja është e rëndësishme për të parandaluar shitjen e paligjshme të kanabisit të rritur në mënyrë të ligjshme dhe për t'u siguruar se lloji i kanabisit të rritur është për përdorim mjekësor dhe jo për përdorim rekreativ. Në letër, rregulloret janë mjaft të rrepta dhe duhet të mbikëqyren nga institucionet qeveritare, duke përfshirë Ministrinë e Bujqësisë dhe atë të Shëndetësisë,⁵⁸ si dhe një komision të posaçëm me pesë anëtarë.⁵⁹ Kultivuesi i kanabisit është i detyruar të mbajë një regjistër të kanabisit të kultivuar (mbjellja, prodhimi i fidanëve, transplantimi dhe numri i bimëve). Pas përfundimit të korrjes së kanabisit, komisioni i posaçëm inspekton artikujt e korrur për të përcaktuar numrin e bimëve të mbledhura dhe masës së njomë.

Por me saq shumë prodhues dhe faktin që kanabisi mund të korret deri në katër herë në vit, ka shqetësim se sistemi aktual rregullator është i pamjaftueshëm. Për shembull, kontrolli joadekuat mund të çojë në hedhjen e kanabisit të prodhuar në mënyrë të ligjshme në tregun e zi në Maqedoninë e Veriut ose kontrabandimin në vendet e treta. Rreziku është real: në fillim të dhjetorit 2020, u vodhën dy tonë kanabis nga depoja e një kompanie të licencuar në fshatin Josifovo, komuna e Valandovës.⁶⁰ Pretendohet se një pjesë e kanabisit përfundoi në Kosovë.⁶¹ Në një rast të veçantë, katër burra (dy nga Shkupi dhe një nga Shqipëria dhe Kosova) vodhën 60 kilogramë marijuanë nga depoja e një prodhuesi të licencuar kanabisi në rajonin e Krushevës.⁶²

Një rast i profilit të lartë në Serbi tregon gjithashtu rrezikun e mungesës së rregulloreve dhe marrëdhëniet komode midis prodhuesve dhe zyrtarëve shtetërorë. Në nëntor 2020, më pak se 50 kilometra nga kryeqyteti serb, policia zbuloi plantacionin më të madh të marijuanës në Evropë në një fermë bio të profilit të lartë të njohur si Jovanjica që është në pronësi të biznesmenit Predrag Kolvujija. Një kontroll i pronës zbuloi pothuajse katër tonë marijuanë të papërpunuar, duke përfshirë 650 kilogramë produkt të gatshëm për shitje.⁶³ Një kompleks nëntokësor me dhjetëra bodrume ishte shndërruar në laboratorë të kanabisit të llojit "skunk". Marijuana rritej gjithashtu në nëntë hangarë mbi tokë dhe paketohej dhe ruhej nëpër depo dhe zyra. Thuhet se kudo në pronë ishin instaluar bllokues të telefonave celularë. Askush nuk mund t'i afrohej pronës pa kaluar një kontroll të rreptë. Rrotull gjithë pronës ishin vendosur forca sigurie të armatosura, duke përfshirë ish-anëtarë të njësisë speciale anti-terror. Ata ishin të pajisur me pistoleta, kamera termike për mbikëqyrje natën dhe pushkë anti-dron.⁶⁴

Çështja ka bërë shumë bujë në Serbi për shkak të lidhjeve të pretenduara midis pronarit të fermës Jovanjica dhe Partisë Progresive në pushtet në vend, duke nxitur akuza në lidhje me bashkëpunimin e shtetit me krimin e organizuar.⁶⁵ Madje është kërcënuar edhe një gazetar që mbulon çështjen.⁶⁶ Gjyqi kundër Kolvujijas dhe bashkëpunëtorëve të tij vazhdon. Vlen të përmendet se Kolvujija ka qenë i angazhuar në rritjen e kanabisit për qëllime mjekësore në Maqedoninë e Veriut.⁶⁷



Kompleksi i prodhimit të marjuanës Jovanjica. Foto: Jelena Zoric/N1 TV.

Ndërsa kërkesa për produkte të kanabisit mjekësor është e kufizuar, ekziston një treg i konsiderueshëm për kanabisin e thatë në rajon. Marijuana është droga më e konsumuar në Ballkanin Perëndimor. Për më tepër, Maqedonia e Veriut është një qendër e rëndësishme tranziti për trafikimin e kanabisit të prodhuar në Shqipëri. Droga trafikohet përtej kufirit më këmbë, duke përdorur kuaj ose gomarë dhe kamionë apo edhe varka përtej Liqenit të Ohrit.⁶⁸ Disa prej tyre kalojnë në veri përmes Kosovës ose Serbisë në Evropën Qendrore dhe Perëndimore, ndërsa disa kalojnë përmes Bullgarisë dhe Greqisë. Kanabisi kontrabandohet gjithashtu nga Shqipëria përmes Maqedonisë së Veriut në Turqi. Atje, ajo shpesh shkëmbehet për heroinë, e cila kthehet përmes Maqedonisë së Veriut, me destinacion përfundimtar Shqipërinë.⁶⁹ Do të ishte mjaft e lehtë të futej kanabisi i prodhuar në Maqedoninë e Veriut brenda këtyre flukseve të paligjshme të përcaktuara mirë.

Duke pasur parasysh këto rreze, nga një perspektivë biznesi dhe sigurie do të tregonte maturi nëse qeveria e Maqedonisë së Veriut do të ndalonte dhënien e licencave për kultivimin e kanabisit. Përndryshe, tregu do të ngopet, gjë që nuk është tërheqëse për investitorët, dhe do të jetë i vështirë për t'u rregulluar.

Është e mundur që disa investitorë po llobojnë për një amendament të mundshëm në ligj që do të mundësonte përdorimin dhe eksportimin e kanabisit të thatë. Kjo mund ta hapë Maqedoninë e Veriut ndaj turizmit të drogës, në një kohë kur Amsterdam po mendon të shkojë në drejtim të kundërt duke ndaluar hyrjen e të huajve në kafenet ku konsumohet kanabisi. Ndërsa legalizimi i kanabisit do të gjeneronte të ardhura nga taksat aq të nevojshme, ai mund të përshpejtojë gjithashtu rreziqet e shëndetit publik dhe efektet anësore të lidhura me krimin nga një rritje e trafikut

të kanabisit në Maqedoninë e Veriut. Për shembull, përvoja nga Shtetet e Bashkuara tregon se prodhimi i marjuanës në tregun e zi është në rritje, kryesisht në shtetet që e kanë legalizuar marjuanën.⁷⁰

Vlen të përmendet se në maj të vitit 2020, kryeministri shqiptar Edi Rama njoftoi se qeveria e tij po punonte për një projektligj për legalizimin e kultivimit të kanabisit për qëllime mjekësore, i cili së shpejti do t'i prezantohej publikut.⁷¹ Njoftimi prodhoi skepticizëm te disa pasi Shqipëria ka qenë prej kohësh e njohur për kultivimin e paligjshëm të kanabisit. Edhe opozita dhe kritikë të tjerë kanë shprehur skepticizëm në lidhje me nismën, duke argumentuar se për një vend me një histori të gjatë të kultivimit të paligjshëm, legalizimi i kanabisit mjekësor do të inkurajonte më tej prodhimin e paligjshëm dhe do të komplikonte përpjekjet e vendit për të kontrolluar problemin. Që nga njoftimi i kryeministrit, nuk ka pasur shumë informacione vijuese, dhe besohet se çështja nuk do të rishikohet përpara zgjedhjeve të përgjithshme të prillit 2021.

Me pak fjalë, qëndrimet dhe ligjet në lidhje me kanabisin po ndryshojnë. Në dhjetor 2020, Komisioni i OKB-së për Lëndët Narkotike e hoqi kanabisin nga Lista IV e Konventës Unike të vitit 1961 mbi Lëndët Narkotike. Ky vendim ka hapur dyert për njohjen e potencialit mjekësor dhe terapeutik të kësaj droge. Por sfida mbeten për të siguruar një kuadër efektiv rregullator për prodhimin, përdorimin dhe shitjen e kanabisit. Vendet në Ballkanin Perëndimor ku ka një sasi të konsiderueshme të kultivimit të kanabisit, si Shqipëria dhe Serbia, pa dyshim që po i ndjekin nga afër zhvillimet në Maqedoninë e Veriut. Çdo plan për të legalizuar kanabisin mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në politikë, shëndetësi, turizëm, ekonomi dhe tregjet e drogës në rajon.

5. Fuqizimi i të rinjve në Vlorë.

Qendra Rinore e Vlorës (Mora Youth Center - VYC) u krijua në këtë qytet bregdetar të Shqipërisë së jugut në vitin 1998, në një kohë paqëndrueshmërie të shkaktuar nga trazirat civile pas rënies së skemave piramidale. Në vitin 2002, projekti u regjistrua si OJQ. Në dy dekadat e fundit, VYC ka kontribuar në angazhimin e të rinjve në jetën publike, qëndrueshmërinë e ndërtimit të komunitetit dhe barazinë gjinore. Alketa Dhimitri, drejtoresha e qendrës, diskuton punën e tyre si dhe sfidat dhe mundësitë që ajo sheh.



Alketa Dhimitri, drejtoreshë e VYC.

A mund të na tregoni për ditët e para të qendrës?

Në ditët e para të saj, VYC ishte një projekt i organizatave lokale të mbështetura nga Konsorciumi Italian i Solidaritetit, për t'u dhënë të rinjve një alternativë ndaj krimit, pasi trazirat kishin bërë që shumë të rinj të kishin armë në duar dhe të ishin pjesë e bandave të fuqishme të qytetit. Megjithatë situata është përmirësuar ndjeshëm, Vlorë ende vuan nga një reputacion i keq si një vend ku krimi i organizuar prodhon "ekspertë" që i aplikojnë aftësitë e tyre në Shqipëri dhe në të gjithë botën.

Cilat janë disa nga sfidat me të cilat përballemi për të punuar me të rinjtë në Vlorë?

Me mbi 22 vjet përvojë, ne kemi kuptuar më mirë situatën këtu dhe sfidat me të cilat përballemi të rinjtë. Puna me të rinjtë në Vlorë mund të jetë e vështirë, pjesërisht për shkak se atyre u mungojnë modelet pozitive. Mund të jetë e vështirë t'u ndryshohen pikëpamjet dhe sjellja të rinjve që janë përfshirë në aktivitete të paligjshme që në moshë të hershme. Është gjithashtu problematike gjetja e alternativave praktike për të rinjtë që pritet të marrin përsipër "biznesin" e familjes, veçanërisht në zonat e thella dhe të pafavorizuara.

Brezi i ri nganjëherë preferon paratë e lehta në vend që të përpiqet të bëjë një jetë të ndershme, dhe kjo tendencë përforcohet nga mungesa e mundësive të ligjshme të punës. Duke përfutur nga vulnerabiliteti ekonomik, grupet kriminale e kanë të lehtë të rekrutojnë të rinjtë duke i paguar ata për të kryer punë të tilla si ruajtja e plantacioneve të kanabisit, transportimi i produktit dhe shpërndarja e tij. Hap pas hapi, kjo bën që të rinjtë të përfshihen më thellë në krim.

Krimi i organizuar gjithmonë duket se është disa hapa përpara strukturave shtetërore, komunitetit dhe organizatave lokale, dhe pasojat e kësaj janë afatgjata. Bashkëpunimi i pamjaftueshëm midis komunitetit, rinisë dhe institucioneve lokale pengon përpjekjet për të përmirësuar situatën. Një bashkëpunim më i mirë mund të forconte zhvillimin e përgjithshëm social-ekonomik të rajonit.

Si kontribuon organizata juaj në përmirësimin e jetës së të rinjve?

Me krenari mund të themi se gjatë dy dekadave të fundit kemi kontribuar në shumë raste pozitive në të cilat të rinjtë kanë arritur të përmirësojnë gjendjen e tyre social-ekonomike. Ata tani bëjnë një jetë më të sigurt të orientuar drejt punës së ndershme në një nga sektorët e shumtë të bazuar në burimet natyrore të Vlorës, siç janë bujqësia ose turizmi malor dhe detar.

Prioriteti ynë është t'i ndihmojmë të rinjtë të zgjerojnë vizionin e tyre, të kërkojnë dhe të marrin mbështetje, informacione dhe inkurajim drejt mundësive të ligjshme të biznesit dhe jetesës. Ne i lidhim të rinjtë me bashkëmoshatarët e tyre dhe u ofrojmë atyre modele frymëzuese dhe pozitive të zhvillimit të vetes.

Për më tepër, ne ofrojmë mundësi për punësim dhe sipërmarrje në fushën e agro-turizmit, siç janë përpunimi dhe shitja e produkteve lokale. Duke i trajnuar të rinjtë në administrimin e biznesit, kërkesat për regjistrimin e biznesit dhe standardet e sigurisë ushqimore, ne i kemi ndihmuar ata të kenë akses në tregje për produktet e tyre artizanale. Na pëlqen ta bëjmë këtë trajnim sa më praktik që të jetë e mundur. Për shembull, ne kemi zhvilluar turne studimore në disa nga bizneset më të suksesshme të agro-turizmit në Shqipëri për të mësuar nga shembulli dhe përvoja e tyre, të tilla si në prodhimin e ëmbëlsirave ose në prodhimin e verës.



Të rinjtë marrin pjesë në një iniciativë të Qendrës Rinore Vlorë. Foto: VYC

Përjetimi në mënyrë praktike i shembujve të tillë të mirë të bujqësisë dhe praktikave të turizmit u ka dhënë mundësinë të rinjve të shohin vetë se si produktet lokale, madje edhe në zonat e thella, mund të gjenerojnë të ardhura të qëndrueshme. Ne gjithashtu i kemi trajnuar të rinjtë si kuzhinierë dhe guida turistike për t'u dhënë atyre aftësitë që u duhen për të drejtuar një bujtinë ose për të pritur grupe vizitorësh. Këto aktivitete i kanë fuqizuar ata dhe kanë reduktuar vulnerabilitetin e tyre për t'u përfshirë në krimin e organizuar.

Në vitin 2020, me mbështetjen e "Fondit të qëndrueshmërisë" të GI-TOC, ne kemi punuar me të rinjtë në zonat rurale të Vlorës për të përmirësuar mundësitë e tyre të punësimit dhe për t'i pozicionuar ata më mirë për të hyrë në tregjet e punës me mbështetjen e komunitetit dhe bizneseve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse në të kaluarën disa zona rurale të Vlorës janë shfrytëzuar për kultivimin e kanabisit.

Dhe në fshatin Vajzë, ne krijuam një shteg poezie duke përdorur materiale ekologjike si druri, për t'u dhënë të rinjve të zonës një hapësirë të këndshme dhe të sigurt për të qëndruar në shoqërinë e moshatarëve të tyre. Kjo ofron një model për të promovuar arsimin dhe kulturën dhe për të frymëzuar të rinjtë që të jenë të hapur para alternativave dhe ndryshimeve pozitive. Shpresojmë që kjo të mundë të nxisë gjithashtu fillimin e infrastrukturës së turizmit ekologjik në fshat.

Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballet rinia sot në Vlorë?

Megjithëse të rinjtë njihen kryesisht si agjentë të ndryshimeve shoqërore, angazhimi i tyre në shoqërinë shqiptare është i kufizuar. Faktorët që kontribuojnë në indiferencën dhe apatinë e të rinjve përfshijnë mungesën e besimit të sistemi, distancimin nga politika, mundësitë e kufizuara dhe ndjenjën e kufizuar të shpresës ose perspektivës. Gjithashtu, disa prej tyre nuk kanë aftësi të mjaftueshme për jetën dhe modele pozitive.

Në shumë raste, të rinjtë vendosin të largohen nga Vlora për mundësi më të mira diku tjetër, qoftë në Shqipëri ose jashtë saj. Kjo ndikon në vazhdimësinë e disa ndërhyrjeve tona.

Rinia është një burim i pashfrytëzuar në Shqipëri, jo vetëm në Vlorë. Duhet bërë shumë më tepër për t'i angazhuar dhe fuqizuar të rinjtë në nivel vendor, pasi ata janë një aset i vlefshëm për jetën në komunitet.

Çfarë mund të bëjnë më shumë autoritetet vendore dhe kombëtare, si edhe shoqëria civile, për të mbështetur të rinjtë?

Autoritetet vendore janë përgjegjëse për të garantuar që qeveria vendore i shërben komunitetit. Sidoqoftë, të rinjtë kanë përfaqësim të ulët në qeverisjen vendore dhe nuk kanë një mënyrë për t'i bërë të ditura nevojat dhe shqetësimet e tyre.

Punësimi i vazhdueshëm është jetësor. Kjo kërkon investime në ndërtimin e kapaciteteve dhe fuqizimin ekonomik të të rinjve. Dhe integrimi i të rinjve në proceset pjesëmarrëse do të ndihmonte në angazhimin e tyre politik. Por këto gjëra kërkojnë një mjedis mundësues.

Ndërkohë që qeveritë kanë qenë të pasuksesshme në arritjen e këtij qëllimi, organizatat e shoqërisë civile që kanë njohuri të gjera mbi dinamikat vendore, si Qendra Rinore e Vlorës, po gjejnë mënyra për të angazhuar, promovuar dhe forcuar rininë përmes praktikave të qeverisjes së mirë në nivelin vendor.

Nga njëra anë, ne përpiqemi të rrisim kapacitetin e të rinjve në mënyrë që ata të mund të kuptojnë dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre social-ekonomike. Ne e bëjmë këtë përmes projekteve të tilla si parlamenti rinor i Vlorës, këshilli vendor i të rinjve dhe akademia e drejtuesve të rinisë.

Nga ana tjetër, ne i këshillojmë ata në angazhimin në procese pjesëmarrëse, përmes projekteve të tilla si buxhetimi i pjesëmarrjes dhe diçka që quhet karta vlerësuese e bazuar në komunitet. Kjo e fundit u mundëson të rinjve të identifikojnë nevojat e tyre dhe të përkrahin nisma konkrete me qeverinë vendore, për shembull në lidhje me infrastrukturën publike, shërbimet e të rinjve ose punësimin. Kjo u jep atyre mundësinë të shprehen dhe i sjell ata në kontakt dhe dialog me zyrtarët vendorë. Ajo ndihmon gjithashtu qeverinë vendore të ndërtojë politika më konstruktive dhe përfaqësuese për t'u shërbyer më mirë qytetarëve të saj.

FALËNDERIMET

Ky Buletin i Rreziqeve është një publikim i Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore (SEE-Obs), në kuadër të Iniciativës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

SEE-Obs është një platformë që mbledh së bashku dhe fuqizon organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, dhe në Serbi. Observatori kërkon t'i krijojë mundësi shoqërisë civile që të identifikojë, analizojë dhe të krijojë një tablo të prirjeve dhe tendencave kriminale, si dhe ndikimin e tyre mbi trafiket e paligjshme, qeverisjen, zhvillimin, marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe respektimin e ligjit. SEE-Obs mbështet organizatat e shoqërisë civile në punën e tyre për monitorimin e zhvillimeve dhe tendencave të krimit të organizuar në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Observatori u krijua në vitin 2018, pas takimit të Londrës mbi vendet e Ballkanit perëndimor, në kuadër të Procesit të Berlinit.

Ne dëshirojmë të falënderojmë Ana Milosavljeviç, Ivica Simonovski dhe Jelena Jovanoviç për kontributin e tyre të çmuar.

Shënime

- 1 *Dvoje povredeno u pucnjavi, ranjena slučajna prolaznica*, Radio Sto Plus, 15 dhjetor 2020, www.radiostoplus.com/item/30555.
- 2 Beta, *Pucnjava u Novom Pazaru, ranjen muškarac*, N1, 17 dhjetor 2020, rs.n1info.com/vesti/a684701-pucnjava-u-novom-pazaru-ranjen-muskarac.
- 3 *Vulin: Država neće dozvoliti obračune kriminalnih bandi u Novom Pazaru*, RTS, 17 dhjetor 2020, www.rts.rs/page/stories/ci/story/124/drustvo/4189973/vulin-obracun-bande-novi-pazar.html.
- 4 Shifra zyrtare e popullsisë është 107 071, por vlerësimi jozyrtar është 120 000. Zyra e Statistikave Serbe, profili i Novi Pazarit, nëntor 2020, devinfo.stat.gov.rs/SerbiaProfileLauncher/files/profiles/sr/1/DI_Profil_Novi%20Pazar_EURSRB002001007003.pdf.
- 5 Ibid.
- 6 Shërbimi kombëtar i punësimit, buletini mujor statistikor nr. 219, nëntor 2020, www.nsz.gov.rs/live/digitalAssets/15/15623_bilten_nsz_novembar_2020.pdf.
- 7 Intervistë me një përfaqësues të një organizate të shoqërisë civile, Novi Pazar, tetor 2020.
- 8 Ibid.
- 9 Raporti i Strategjisë Ndërkombëtare të Kontrollit të Narkotikëve, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, mars 2008, (International Narcotics Control Strategy Report, United States Department of State) fq. 492, , 2009-2017.state.gov/documents/organization/102583.pdf.
- 10 Trafikanti përsëritës kapet në një bastisje të madhe të heroinës, (Repeat trafficker caught in large heroin bust), OCCPR, 18 tetor 2011, www.occrp.org/en/daily/1174-repeat-trafficker-caught-in-large-heroin-bust.
- 11 Intervistë me një inspektor policie, Novi Pazar, nëntor 2020.
- 12 Ibid.
- 13 Përgjigjja zyrtare e Ministrisë së Brendshme, Departamenti i Policisë së Novi Pazarit, 9 nëntor 2020.
- 14 Intervistë me një përdorues të drogës, Novi Pazar, nëntor 2020.
- 15 Intervistë me prokurorin publik, Novi Pazar, nëntor 2020.
- 16 Ibid.
- 17 Ibid.
- 18 Intervistë me një gazetar nga Novi Pazar, janar 2021.
- 19 K S dhe J P, *Pucnjava na Vračaru: Narko-diler (40) ranjen u Kursulinoj ulici, prevezen na reanimaciju*, Blic, 29 dhjetor 2019, www.blic.rs/vesti/beograd/pucnjava-na-vracaru-narko-diler-40-ranjen-u-kursulinoj-ulici-prevezen-na-reanimaciju/843vkr4.
- 20 Intervistë me një gazetar nga Novi Pazar, janar 2021.
- 21 Instituti Ndërkombëtar i Sirakuzës për Drejtësi Penale dhe të Drejtat e Njeriut, Mbyllja e hendekut të implementimit (Siracusa International Institute for Criminal Justice and Human Rights, Closing the implementation gap): Përgjigjet e drejtësisë penale ndaj tregtisë së paligjshme në Evropën Juglindore dhe sfidat që i shoqërojnë ato, (Criminal justice responses to illicit trade in South Eastern Europe and associated challenges), nëntor 2020, fq. 125, www.siracusainstitute.org/app/wp-content/uploads/2020/11/SII-Regional-crime-trends-report_web.pdf.
- 22 Intervistë me një ish-oficer policie nga njësia anti-drogë e Beogradit, Beograd, nëntor 2020.
- 23 Intervistë me një oficer policie, Beograd, dhjetor 2020.
- 24 Intervistë me një profesor të kriminologjisë, Beograd, dhjetor 2020.
- 25 Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile, Beograd, nëntor 2020.
- 26 Intervistë me një ish-oficer policie, Beograd, dhjetor 2020.
- 27 Bazar në një analizë të deklaratave të ndryshme për shtyp të Ministrisë së Brendshme, mup.gov.rs/wps/portal/sr/.
- 28 Jelena Radivojević, *Zarubici 11 godina zatvora zbog proizvodnje droge*, KRIK, 25 shtator 2018, www.krik.rs/zarubici-11-godina-zatvora-zbog-proizvodnje-droge.
- 29 Ministria e Brendshme e Serbisë, Vlerësimi i Kërcënimit të Krimin të Rëndë dhe të Organizuar (Serbian Ministry of Interior, Serious and Organized Crime Threat Assessment), 2020, fq. 47, mup.gov.rs/wps/wcm/connect/3d0a3df4-4e1d-4b70-8475-3d69f6d21107/SOCTA+2019+-+ENG-compressed.pdf?MOD=AJPERES&CVID=nnvYIq8. Shikoni gjithashtu: Siracusa Institute, op. cit., p 49.
- 30 Qendra e Zbatimit të Ligjit të Evropës Juglindore, Raport mbi Konfiskimet e Drogave në Evropën Juglindore (Southeast European Law Enforcement Center, Report on Drug Seizures in Southeast Europe), dhjetor 2019, fq. 23, www.selec.org/wp-content/uploads/2019/12/SELEC-Report-on-Drug-Seizures-2019-Public-version.pdf.
- 31 Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile, Beograd, nëntor 2020.
- 32 Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile, Beograd, nëntor 2020.
- 33 Irena Molnar, *Përdorimi i substancave të reja psikoaktive në Republikën e Serbisë (New psychoactive substance use in the Republic of Serbia): Rezultatet e hulumtimit (Research results)*, Eurasian Harm Reduction Association and School of Law, Swansea University, 2020, fq. 26, harmreductioneurasia.org/wp-content/uploads/2020/09/2020_8_20_EHRA_NPS-Report_Serbia_EN.pdf.
- 34 Intervista me aktivistë të shoqërisë civile në Beograd, nëntor 2020 dhe Podgoricë, dhjetor 2020.
- 35 Ibid.
- 36 Intervistë me një ish-oficer policie, Beograd, dhjetor 2020.
- 37 Saša Djordjević dhe Bojan Dobovšek, Krimi i organizuar në Gjashtë Vendet e Ballkanit Perëndimor në fillim të koronavirusit (Saša Djordjević and Bojan Dobovšek, Organized crime in Western Balkans Six at the onset of coronavirus), *International Journal of Sociology and Social Policy*, 40, 9/10, 807–820, doi.org/10.1108/IJSSP-06-2020-0229.
- 38 Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile, Beograd, nëntor 2020.
- 39 Podaci o preminulima od posledica vezanih za korišćenje droge u Srbiji u periodu 2008-2019. godine, Drug Policy Network South East Europe, dhjetor 2020, fq. 8.
- 40 N G dhe M M, 'Svako zna da nabroji bar 50 dilera', Sofija (15) je umrla posle jedne tablete ekstazija, a godinu dana posle smrti, njeni sugrađani su na nogama, Blic, 15 nëntor 2019, www.blic.rs/vesti/drustvo/svako-zna-da-nabroji-bar-50-dilera-sofija-15-je-umrla-posle-jedne-tablete-ekstazija-a/gfr3bs1.
- 41 Podaci o preminulima od posledica vezanih za korišćenje droge u Srbiji u periodu 2008-2019. godine, Drug Policy Network South East Europe, dhjetor 2020, fq. 8.
- 42 *Gomonia me 55 emigrantë në bord nga Vlora drejt Italisë/ Arrestohet 63 vjeçari nga Tirana. Roli që kishte ai*, Panorama, 10 janar 2021, www.panorama.com.al/trafiku-i-emigranteve-drejt-italise-me-gomone-arrestohet-63-vjecari-nga-tirana-rol-i-ke-kishte-ai.
- 43 *Rikthehet trafiku me gomone drejt Italisë, shpëtohen 55 emigrantë në det*, Zëri i Amerikës (VOA), 9 janar 2021, www.zeriamerikes.com/a/5731085.html.
- 44 Jerola Ziaj, *Trafik klandestinësh me gomone, policia ndalon 21 emigrantë dhe arreston pronarin e një shtëpie stehimi*, Reporter, 4 qershor 2020, www.reporter.al/trafik-klandestinesh-me-gomone-policia-ndalon-21-emigrante-dhe-arreston-pronarin-e-nje-shtepie-stehimi.
- 45 Isa Myzyraj, *Përsëri emigrantë/ 9 Janari i 2004 dhe 9 Janari i 2021*, Historia ime, 9 janar 2021, www.historiaime.al/ndodhi-sot/perseri-emigrante-9-janari-i-2014-dhe-9-janari-i-2021.
- 46 *Moratoriumi i skafeve, rrezik per turizmin*, Top Channel, 22 qershor 2009, top-channel.tv/2009/06/22/moratoriumi-i-skafeve-rrezik-per-turizmin.
- 47 *Moratoriumi i skafeve, pas 7 vjetësh rikthehet liria e lundrimit*, Durrës Lajm, 2 mars 2013, durrreslajm.al/moratoriumi-i-skafeve-pas-7-vjet%C3%ABsh-rikthehet-liria-e-lundrimit.

- 48 Intervistë me një gazetar nga Mali i Zi, dhjetor 2020.
- 49 Emma Wallis, 52 migrantë të interceptuar nga autoritetet malazeze gjatë rrugës për në Itali (52 migrants intercepted by Montenegrin authorities on route to Italy), Info Migrants, 19 tetor 2020, www.infomigrants.net/en/post/27994/52-migrants-intercepted-by-montenegrin-authorities-en-route-to-italy.
- 50 Intervistë me një oficer policie nga Mali i Zi, dhjetor 2020.
- 51 Ibid.
- 52 Jelena Jovanović dhe Blažo Hajduković, *Otkriven brod sa 50 ilegalnih migranata*, Vijesti, 17 dhjetor 2020, www.vijesti.me/vijesti/crna-hronika/495615/up-otkriven-brod-sa-50-ilegalnih-migranata.
- 53 Intervistë me një gazetar nga Vranja, janar 2021.
- 54 Ministria e Shëndetësisë, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë, Nr. 37/2016, zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2017/11/5.-ZAKON-ZA-IZMENUVANE-I-DOPOLNUVANE-NA-ZAKONOT-ZA-KONTROLA-NA-OPOJNI-DROGI-I-PSIHOTROPNI-SUPSTANTSII-Sluzhben-vesnik-na-RM-br.-37-od-2016-godina.pdf.
- 55 Z Uskoković, *U Severnoj Makedoniji legalno gaje travu*, Novosti.rs, 2 gusht 2019, www.novosti.rs/vesti/naslovna/hronika/aktuelno.291.html:809793-U-Severnoj-Makedoniji-legalno-gaje-travu.
- 56 *Ексклузивно: Кои се фирмите кои влегоа во бизнисот со медицинска марихуана во Македонија*, Emagazin, 22 tetor 2020, emagazin.mk/ekskluzivno-koi-se-firmitite-koi-vlegoavo-biznisot-so-medicinska-marihuana-vo-makedoni-a.
- 57 *Полињата со марихуана - нова локација за политичка битка*, Deutsche Welle, 24 janar 2020, www.dw.com/mk/полињата-со-марихуана-нова-локација-за-политичка-битка/a-52134094. Aleksandar Janev, *Македонска канабис револуција во најава*, Prizma, 8 maj 2018, prizma.mk/makedonska-kanabis-revolutsija-vo-najava.
- 58 Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë së Veriut, Ligji për Kontrollin e Lëndëve Narkotike dhe Substancave Psikotrope, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë, Nr. 37/2016, Neni 29-c, zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2017/11/5.-ZAKON-ZA-IZMENUVANE-I-DOPOLNUVANE-NA-ZAKONOT-ZA-KONTROLA-NA-OPOJNI-DROGI-I-PSIHOTROPNI-SUPSTANTSII-Sluzhben-vesnik-na-RM-br.-37-od-2016-godina.pdf.
- 59 Sipas nenit 29-b, paragrafi 5, komisioni formohet nga Ministri i Shëndetësisë. Ai përbëhet nga dy përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, një përfaqësues nga Agjencia e Barnave dhe Produkteve Mjekësore dhe një specialist në fushën e bimëve mjekësore.
- 60 Ministria e Brendshme e Maqedonisë së Veriut, *Приведени лица, се расчистува случајот со украдената марихуана од Јосифово*, 8 dhjetor 2020, mvr.gov.mk/vest/13879.
- 61 Hristina Belovska, *ЛЕГАЛНИОТ БИЗНИС СО МАРИХУАНА ЛЕСНА МЕТА НА КРИМИНАЛНИТЕ ГРУПИ*, Televizija 24, 21 dhjetor 2020, 24.mk/details/legalniot-biznis-so-marikhuana-lesna-meta-na-kriminalnite-grupi.
- 62 Ministria e Brendshme e Maqedonisë së Veriut, *Извршен претрес, запленети околу 60 кг дрога*, 20 dhjetor 2020, mvr.gov.mk/vest/14019.
- 63 Serbia kap katër tonë marijuanë në fermën e ushqimeve bio (Serbia seizes four tonnes of marijuana in organic food farm), Reuters, 26 nëntor 2019, www.reuters.com/article/us-serbia-police/serbia-seizes-four-tonnes-of-marijuana-in-organic-food-farm-idUSKBN1Y01YC.
- 64 Jelena Zorić, *Aktakuza e Jovanovićit (The Jovanjica Indictment)*, N1, 13 shtator 2020, <https://youtu.be/16ksUma446l>.
- 65 Sasha Dragojlo, *Ushqime bio apo drogë (Organic High): Përfshirja shtetërore në fermën serbe të drogës një "njollë" mbi qeverinë (State Complicity in Serbian Drug Farm a 'Stain' on Government)*, BIRN, 27 korrik 2020, balkaninsight.com/2020/07/27/organic-high-state-complicity-in-serbian-drug-farm-a-stain-on-government.
- 66 IJAS, *kërcënime të reja ndaj Jelan Zorić të N1 raportohen në polici, thotë avokati (IJAS, New threats to N1's Jelan Zoric reported to police, lawyer says)*, 15 janar 2021, safejournalists.net/new-threats-to-n1s-jelan-zoric-reported-to-police-lawyer-says.
- 67 *Бизнис партнерот на Заеви под сомнение за црна prodazba на марихуана: Што најде полицијата кај него?*, Kurir, 30 nëntor 2019, kurir.mk/makedonija/vesti/biznis-partnerot-na-zaevi-pod-sommenie-za-crna-prodazba-na-marihuana-shto-najde-policijata-kaj-nego.
- 68 Ibid.
- 69 Ibid.
- 70 Administrata e Zbatimit të Ligjit për Drogat e Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së, *Vlerësimi Kombëtar i Kërcënimit të Drogave (US Department of Justice Drug Enforcement Administration, 2019 National Drug Threat Assessment)*, dhjetor 2019, www.dea.gov/sites/default/files/2020-01/2019-NDTA-final-01-14-2020_Low_Web-DIR-007-20_2019.pdf.
- 71 /> Fatjoni Mejdini, *Burimi i madh i kanabisit të paligjshëm, Shqipëria mendon legalizimin e përdorimit mjekësor (Fatjoni Mejdini, Big source of illicit cannabis, Albania mulls legalising medical use)*, BIRN, 25 maj 2020, balkaninsight.com/2020/05/25/big-source-of-illicit-cannabis-albania-mulls-legalising-medical-use.

“Buletinet e rreziqeve” janë publikime periodike nga observatorët tanë rajonalë, në bashkëpunim me rrjete të shoqërisë civile për të paraqitur të dhëna të reja dhe për të kontekstualizuar prirjet e rrjeteve të krimit të organizuar, tregtisë së paligjshme, dhe reagimit të shtetit ndaj tyre. Nëse doni të abonoheni për të marrë numrat e ardhshëm të “Buletinit të rreziqeve”, ju lutemi regjistrohuni [këtu](#) ose dërgoni email në Kristina.Amerhauser@globalinitiative.net.

MBI INICIATIVËN GLOBALE

Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet mbarëbotëror, i përbërë nga më shumë se 500 ekspertë të shpërndarë nëpër të gjithë globin. Iniciativa Globale ka krijuar një platformë për nxitjen e një debati më të gjerë dhe promovimin e përfaqësive inovative, për të krijuar një bazë të fortë për hartimin e një strategjie në nivel global kundër krimit të organizuar.

www.globalinitiative.net

Ky publikim u realizua me mbështetjen financiare të Fondit të Mbretërisë së Bashkuar për Konflikt, Stabilitet dhe Siguri. Përgjegjësia mbi përmbajtjen e këtij publikimi bie vetëm mbi GI-TOC, dhe përmbajtja nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.



**GLOBAL
INITIATIVE**
AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME